



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr. 948 Prot.

Tiranë, më 24. 9 .2020

### PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 584/1 Prot.

Tiranë, më 24. 09 .2020

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

#### NISUR NGA:

Shqetësimi i opinionit publik shqiptar për nivelin e lartë të shpërdorimeve të fondeve publike, prioritetet e institucioneve shqiptare dhe kërkesat e vazhdueshme të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë për forcimin e luftës kundër veprave penale të kryera nga punonjësit e administratës publike në Shqipëri;

#### ME SYNIM:

Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, duke respektuar pavarësinë e veprimtarisë së prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, për forcimin e luftës kundër kriminalitetit të kryer nga punonjësit e administratës publike;

#### DUKE RIAFIRMUAR:

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucioneve;

#### NË MBËSHTETJE TË:

Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "gj", ku parashikohet: "t'u drejtohet organeve të ndjekjes penale në rastet kur ndjekja e mëtejshme e zbulimeve nga auditimi është kompetencë e tyre", si dhe neni 38, pika 2, shkronja "ë", e vijuse të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

**Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH)**, përfaqësuar nga **Kryetari, Z. Arben SHEHU**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

dhe

**Prokuroria e Përgjithshme (PP)**, përfaqësuar nga **Prokurori i Përgjithshëm, Z. Olsian ÇELA**, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

**bien dakord për Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë:**

## **NENI 1 OBJEKTIVI**

- 1.1** Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve midis dy institucioneve me qëllim evidentimin e saktë të shkeljeve, që përbëjnë vepër penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj.
- 1.2** Marrja e masave për hartimin e rregullt të kallëzimeve penale, kryerjen e hetimeve paraprake, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në afate sa më të shpejta, në zbatim të ligjit penal dhe procedural penal.
- 1.3** Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe shpërdorimit të fondeve publike.
- 1.4** Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të palëve në këtë marrëveshje.
- 1.5** Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për realizimin e detyrave respektive, pa cënuar diskrecionin e njëra-tjetrës dhe sekretin hetimor.

## **NENI 2 KONTRIBUTI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

- 2.1** Në rastet kur KLSH bën kallëzim penal në prokurori, materiali, përveç kërkesave të parashikuara në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të shoqërohet edhe me një relacion përmbledhës të faktit të konstatuar, ku të shënohen elementët e veprës/veprave penale, shkeljet e akteve ligjore e nënligjore dhe pasojat e ardhura; me akt-konstatimet dhe çdo dokument tjetër të mbajtur nga audituesit e KLSH-së në lidhje me faktin e kallëzuar dhe të referuar si vepër penale; me observacionet e personave përgjegjës ku paraqiten pretendimet e tyre dhe çdo dokument tjetër që vlerësohet i nevojshëm për hetimin dhe zbulimin e veprës/veprave penale dhe autorëve të tyre.
- 2.2** KLSH angazhohet të zhvillojë një metodologji lidhur me procedurat e hetimit administrativ dhe të referimit në prokurori të veprave penale.
- 2.3** Zhvillimi metodologjisë dhe zbatimi i saj do të pasohet me trajnime të përbashkëta midis KLSH-së dhe Prokurorisë.
- 2.4** Në çdo rast kur KLSH konstaton ekzistencën e elementeve të veprave penale me pasoja jo të lehta dhe përfshirjen në të të disa punonjësve të administratës publike etj. dërgon menjëherë kallëzim në prokurorinë kompetente të juridiksionit të përgjithshëm, në mënyrë që, prokurorët, të kenë mundësi të vlerësojnë në një kohë sa më të shpejtë regjistrimin ose jo të procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve proaktive, me qëllim zbulimin e veprimtarisë të gjithë subjekteve të përfshirë në kryerjen e veprave penale dhe sigurimin e provave për vërtetimin e fajësisë.

## **NENI 3 KONTRIBUTI I PROKURORISË**

- 3.1 Prokurori i Përgjithshëm në bazë të nenit 38, pika 2, germa “b”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, angazhohet të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm për hetimin e veprave penale të kallëzuara nga KLSH-ja për të normuar marrëdhëniet e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm dhe oficerëve të policisë gjyqësore që ushtrojnë ndjekjen penale për kallëzimit e bëra nga KLSH-ja me audituesit e KLSH-së, pa cënuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale.
- 3.2 Prokuroria<sup>1</sup> kur ka njoftime (indicie) për veprimtari në shkelje të ligjit nga punonjës të administratës publike që nuk përbëjnë bazë për regjistrimin e procedimit penal mund të sugjerojë iniciimin e auditimeve përkatëse nga KLSH-ja.
- 3.3 Prokuroria e Përgjithshme do të kontribuojë me komente gjatë procesit të hartimit të metodologjisë lidhur me procedurat e hetimit administrativ dhe të referimit në prokurori të veprave penale, të parashikuar në pikën 2.2 të kësaj marrëveshjeje dhe do të garantojë mbështetjen për trajnime dhe pjesëmarrje në trajnime të përbashkëta me KLSH-në për zbatimin e kësaj metodologjie.
- 3.4 Prokuroria e Përgjithshme angazhohet për përgatitjen e një metodike hetimi lidhur me hetimin e veprave penale në fushën e krimit ekonomik, shpërdorimit të fondeve publike, prokurimeve, administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj.

#### **NENI 4 KONTRIBUTE TË PËRBASHKËTA**

- 4.1 Palët marrim përsipër që të organizojnë takime të përbashkëta periodike ndërmjet punonjësve të KLSH-së, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e krimit ekonomik, me qëllim shkëmbimin e opinionëve dhe eksperiencave për kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të rasteve për të cilat bëhet kallëzimi penal, të cilat janë objekt i punës së dy institucioneve

#### **NENI 5 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE**

- 5.1 Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
- 5.2 Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshjeje.
- 5.3 Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

#### **NENI 6 ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT**

---

<sup>1</sup> Prokuroria pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

- 6.1 Informacioni i shkëmbyer mes palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale; ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar; ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

**NENI 7**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**

- 7.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 7.2 Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje nga palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 7.3 Megjithësa është parashikuar në pikën 7.1 të këtij neni, kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht, me shkrim, palën tjetër.
- 7.4 Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe dy të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme.

Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, në datën \_\_\_ / \_\_\_ / 2020.

**PËR**  
**KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT**

**KRYETARI**  
**ARBEN SHEHU**



**PËR**  
**PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

